4	Kontroll dhe shërbime teknike në NJËSI e jashtme pompë nxehtesie, MULTI-SPLIT me 5 dalje type, kompresor inverter, gas pune R410A, 1faze/ 50Hz/ 230V Kapaciteti 12.1 kW ftohjeVmed.=5200 m³/h, Fuqia eletrike 5.02 kWI kompletuar me te gjithë Aksesoret e nevojshem per funksionim normal (komplet 2)	2	Nr sherbimeve preventive	6	12
5	Kontroll dhe shërbime teknike në POMPË TË QARKULLIMIT TË POMPAVE TE NXEHTËSISË POMPË Centrifugale Horizontale e motor Inverter, me nje shkalle mbeshtetur ne bazament sipas ISO 5199, te lidhet me sistemin BMS me ane te moduleve te komunikimit, Prurja= 202 m3/h; H = 10 m; 3x400V; 14.2 A; P= 7.5 kW; Lidhjet: DN150 ne thithje; DN125 ne dergim; PN16 bar (copë 2)	2	Nr sherbimeve preventive	6	12
6	Kontroll dhe shërbime teknike në Enë zgjerimi 200 litërshe me lidhje 3/4" (4 copë)	4	Nr sherbimeve preventive	2	8
7	Kontroll dhe shërbime teknike në KËMBYES NXEHTËSIE me karakteristikat Teknike: me piastra,-Fuqia 195 kW/h, -Prurja primare 16.76 m3/h, -Temp.in 80°C Temp out 70°C, -Temp.in 12°C Temp out 60°C -Lidhjet 2 ½", ΔP primare = 3.7 mkH2O ΔP sekondare = 2.7 mkH2O		Nr sherbimeve preventive		-
8	Kontroll, Sh.teknike në POMPË QARKULLIMI AHU (Biloku Operator) - Spitali POMPË Qarkulluese in-line binjake (twin head) me nje shkalle me motor Inverter sipas IEC 60034-30-2, me sensor presioni diferencial, te lidhet me sistemin BMS me ane te moduleve te komunikimit dhe me ekran. Prurja= 20.6 m3/h; H = 10 m; 3Fx400V; 7.3 A; P= 2.8 kW; Lidhjet: DN40; Temp Ujit: -25 .120 °C; PN16 bar	2	Nr sherbimeve preventive	6	12

9	Kontroll dhe shërbime teknike POMPË qarkullimi AHU (Blloku Operator) - Materniteti POMPË Qarkulluese in-line binjake (twin head) me nje shkalle me motor Inverter sipas IEC 60034-30-2, me sensor presioni diferencial, te lidhet me sistemin BMS me ane te moduleve te komunikimit dhe me ekran.Prurja= 17.5 m <sup>3</sup> /h; H = 10 m; 3Fx400V; 5.0 A; P= 1.5 kW; Lidhjet: DN40; Temp Ujit: -25 .120 °C; PN16 bar	2	Nr sherbimeve preventive	6	12
10	Kontroll dhe shërbime teknike në Pompë qarkullimi Fan Coil - Materniteti POMPË Qarkulluese in-line binjake (twin head) me nje shkalle me motor Inverter sipas IEC 60034-30-2, me sensor presioni diferencial, te lidhet me sistemin BMS me ane te moduleve te komunikimit dhe me ekran. Prurja= 38.2 m <sup>3</sup> /h; H = 10 m; 3 Fx400V; 6.8 A; P= 2.7 kW; Lidhjet: DN65; Temp Ujit: -25 .120 °C; PN16 bar	2	Nr sherbimeve preventive	6	12
11	Kontroll dhe shërbime teknike në NJËSI e brendshme F.Coil Dysheme, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 2.46/4.92 kW, P.u = 460 l/h, Vmed.=350 m <sup>3</sup> /h, F.el=44 W, 1F ~230V ~50 HzE kompletuar me POMPË kondense, valvol 3- rrugeshe dhe valvola nderprerese,pult komandimi + kabull.(copë 4)	2	Nr sherbimeve preventive	6	12
12	Kontroll dhe shërbime teknike në NJËSI e brendshme F.Coil Dysheme, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 3.21/6.29 kW, P.u = 552 l/h, Vmed.=460 m <sup>3</sup> /h, F.el=57 W, 1F ~230V ~50 HzE kompletuar me POMPË kondense, valvol 3- rrugeshe dhe valvola nderprerese,pult komandimi + kabull. (cope 6)	6	Nr sherbimeve preventive	2	12
13	Kontroll dhe shërbime teknike në NJËSI e brendshme F.Coil Dysheme, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 4.13/8.34 kW, P.u = 710 l/h, Vmed.=600 m <sup>3</sup> /h, F.el=76 W, 1F ~230V ~50 Hz E kompletuar me POMPË kondense, valvol 3- rrugeshe dhe valvola nderprerese,pult komandimi + kabull. (cope 3)	3	Nr sherbimeve preventive	4	12
14	Kontroll dhe shërbime teknike në NJËSI TRAJTIMI AJRI - BLOKU OPERATOR MATERNITETIPrurja e ajrit dergim/kthim 9500 / 8500 m <sup>3</sup> /h .Temperatura / lageshtia ne hyrje te ambientit dimer: 34°C/ 55% , vere 19°C/ 59.5%Renia e presionit te jashtem dergim/kthim 600/250 PaKapaciteti termik ne ngrohje / ftohje: 60.42 kW / 101.85 kW Bateria pas ngrohese elektrike me fuqi 25.69 kW elektrike Fuqia elektrike e ventilatorit / dergim 11 kW 3 F+N/400V/50Hz / kthim 4 kW 3 F+N/400V/50Hz; i kompletuar me Inverter shpejtesie Komplet filtrash, komplet kuader elektrik, set sensoresh, mbrojtje automatike nga ngrirja	1	Nr sherbimeve preventive	6	6

15	Kontroll dhe shërbime teknike në NJËSI TRAJTIMI AJRI E PERGJITHSHME - MATERNITETI Prurja e ajrit dergim/kthim 9600 / 10500 m <sup>3</sup> /h . Renia e presionit te jashtem dergim/kthim 150/150 Pa Kapaciteti termik ne ngrohje / ftohje: 47.1 kW / 48.88 kW Fuqia elektrike e ventilatorit / dergim 4 kW 3 F+N/400V/50Hz / kthim 4 kW 3 F+ N/400V/50Hz Kompletuar me Inverter shpejtesie Efikasiteti i rekuperatorit 74.8/84.5%. Komplet filtrash, komplet kuader elektrik, set sensoresh, rregullator klimaterik	1	Nr sherbimeve preventive	6	6
16	Kontroll dhe shërbime teknike në KOLEKTOR me karakteristika të ndryshme: diametër 5" deri 10" me hyrje -dalje nga 3-5; të pajisur me manometër, termometër dhe saraçineskë shkarkimi material çelik (komplet 9)	4	Nr sherbimeve preventive	2	8
17	Kontroll dhe shërbime teknike në POMPË E QARKULLIMI (Akumul Kembyes Nxehtësie copë 2) Karakteristika teknike: Fuqia elektrike: 0.19 kW, rryma 1.76 A, tension F3~400V,50Hz, prurja 3.5 m <sup>3</sup> / h, Prevalenca 7 mkH <sub>2</sub> O dhe lidhjet: 2" - PN 10	2	Nr sherbimeve preventive	2	4
18	Kontroll dhe shërbime teknike në AKUMUL (uje i ngrohje sanitare copë 2) Karakteristikat teknike: Kapaciteti : 5000 l, Diametri 1600 mm, Lartesi : 1700 mm, Lidhjet hyrje/dalje : 2 ½", Tempmax 90°C, Presioni max 8 bar I kompletuar me te gjitha aksesoret	2	nr sherbimeve preventive	2	4
19	Kontroll dhe shërbim-riparime në: saraçineska kendore me hollandez 1/2" (cope 43), saraçineska kendore me hollandez 3/4" cope 75, saraçineska kendore me hollandez 1" (cope 11). minivalvula nderprerese per pajisjet hidrosanitare (cope 231), valvol nderprerese DN 15 (Ø1/2") (cope 12), " Set kolektoresh 3/4 " ( 2+2 ) x ½" (kit i kompletuar me buketone+ kasete)" (Komplet 9); set kolektoresh 3/4" ( 3+2 ) x ½" (kit i kompletuar me buketone + kasete) (Komplet 20); Set kolektoresh 3/4" (3+3 ) x ½" (kit i kompletuar me buketone + kasete)" (Komplet 4); Set kolektoresh 1 " ( 4+2 ) x ½" (kit i kompletuar me buketone + kasete) (Komplet 5); Set kolektoresh 1 " ( 5+3 ) x ½" (kit i kompletuar me buketone + kasete) (Komplet 4); Set kolektoresh 1 " ( 5+4 ) x ½" (kit i kompletuar me buketone + kasete) (Komplet 1)	1	Nr sherbimeve preventive	2	2
20	Kontroll preventiv POMPË RIQARKULLIMI (uji i ngrohtë sanitare) POMPË Qarkulluese in-line binjake (twin head) me nje shkalle me motor Inverter sipas IEC 60034-30-2, me sensor presioni diferencial, te lidhet me sistemin BMS me ane te moduleve te komunikimit dhe me ekran Prurja= 4 m <sup>3</sup> /h; H = 9 m; 1Fx230 V; 1.33A; P= 2x0.3 kW; Lidhjet: DN40; PN16 bar (cope 2)	2	Nr sherbimeve preventive	6	12
21	Kontroll, matje e tokëzimit (1 herë në vit)	1	Nr sherbimeve preventive	1	1
22	Kontrolli, pastrimi dhe shërbimi i aspiratorëve (elikave) për eliminim disbalancimi gjatë punës	43	Nr sherbimeve preventive	6	258

			preventive		
23	Kontrolli dhe mirëmbajtja e paisjeve elektrike të punës dhe të mbrojtjes	1	Nr sherbimeve preventive	1	1
24	Kontrolli dhe mirëmbajtje e tokëzimit të motorëve elektrik	1	Nr sherbimeve preventive	1	1
25	Bojatisje vaji siperf. metalike		m2	20	-
26	F.v. filtra për AHU 59x59x10, G3 i valëzuar me konrnizë metalike	1	Cope	4	4
27	F.v. filtra për AHU 59x50x10, G3 I valëzuar me konrnizë metalike	1	Cope	4	4
28	F.v. filtra për AHU 59x28x10, G3 I valëzuar me konrnizë metalike	1	Cope	4	4
29	F.v. filtra për AHU 59,3x28,7x29,, F7 me xhepa SP32RH00	1	Cope	4	4
30	F.v. filtra Multi Pak fine dust 59,3x28,7x29,2 8RTE2323/03	1	Cope	8	8
31	F.v. filtra për fancoil (dysHEME+tavanor)	1	Cope	24	24
32	F.v. gaz freon ekologjik R32	1	Kg.	40	40
33	F.v. vaj kompresori të ftohësave	1	Kg.	6	6
34	F.v. graso në elektromotorë, aspiratorë, etj..	1	Kg.	12	12
35	F.v. premistopë sipas faktit	1	Cope	8	8
36	F.v. rripa transmisioni	1	Cope	8	8
37	F.v. termoizolues për tubacionet e ajrit prej llamarine	1	m <sup>2</sup>	12	12
38	F.v. sensor i presionit të ulët të gazit	1	Cope	1	1
39	F.v. sensor i presionit të lartë të gazit	1	Cope	1	1
40	F.v. valvul sigurie 3/4 ne vakum	1	Cope	2	2
41	F.v. termoizolues me trashësi 25 mm për akumulator	1	m <sup>2</sup>	2	2
42	F.v. nxjerrës ajri (çajruesa) rrjeti	1	Cope	4	4
43	F.v. termostat komandimi për fan-coil	1	Cope	4	4
44	F.v. xhunto antivibruese 2e1/2"	1	Cope	2	2
45	F.v. flusostat uji për rrjetin	1	Cope	1	1
46	F.v. maometër uji 10 bar	1	Cope	2	2
47	F.v. termometër uji	1	Cope	1	1
48	F.V.termostat 3F 15 KW per akumul te ujit te ujit te	2	cope	1	

	nxehte				2
	<b>Mirembajtja e ashensorit te maternitetit</b>				-
49	Mirembajtje e rregullt periodike e ashensorit perfshin: 1- Kontrolli periodik mujor te komponenteve te ashensorit sipas protokollit ne piken1 te specifikimeve teknike 2- Riparimi i defekteve qe vijne si efekt i perdorimit normal i ashensorit pa pjese kembimi 3- Pergjigjen per raste emergjencash 4- Nderhyrjet per riparimin e defekteve te ashensoreve me pjese kembimi	1	Nr sherbimeve preventive	12	12
	<b>Mirembajtja e UPS -ve</b>				-
50	Kontroll periodik te U.P.S. 160 KVA,Kontrolli funksional i parametrave te pajisjes se bashku me matjet perkatëse. Kohëmbajtja e pavarur me ngarkesë të punës, nga burimet e tjera të rrymës alternative, që janë linja nga OSHEE dhe motogjenerator. Kontrolli i funksionimit të linjës BY- PASS. Shtrëngimi i morseterisë. Kontrolli i cilësisë së mbrojtjes të furnizimit me energji të pajisjes, si dhe asaj të transmetuar prej saj. Verifikimi i gjendjes së sistemit të tokëzimit, duke iu referuar tokëzimit kryesor të objektit në të cilën është e instaluar UPS-i. Ne te gjitha rastet, si me bateri të inkluduara në UPS ashtu edhe me bateri të jashtme, kryhet ndarja e linjës pozitive nga ajo negative dhe bëhet matja e kapacitetit të të dy linjave. Shtrëngimi i të gjithë urave të lidhjes së baterive në seri. Kontrolli dhe pastrimi i poleve të baterive.	1	Nr sherbimeve preventive	6	6
51	Kontroll periodik te U.P.S. 40 KVA,Kontrolli funksional i parametrave te pajisjes se bashku me matjet perkatëse. Kohëmbajtja e pavarur me ngarkesë të punës, nga burimet e tjera të rrymës alternative, që janë linja nga OSHEE dhe motogjenerator. Kontrolli i funksionimit të linjës BY- PASS. Shtrëngimi i morseterisë. Kontrolli i cilësisë së mbrojtjes të furnizimit me energji të pajisjes, si dhe asaj të transmetuar prej saj. Verifikimi i gjendjes së sistemit të tokëzimit, duke iu referuar tokëzimit kryesor të objektit në të cilën është e instaluar UPS-i. Ne te gjitha rastet, si me bateri të inkluduara në UPS ashtu edhe me bateri të jashtme, kryhet ndarja e linjës pozitive nga ajo negative dhe bëhet matja e kapacitetit të të dy linjave. Shtrëngimi i të gjithë urave të lidhjes së baterive në seri. Kontrolli dhe pastrimi i poleve të baterive.	1	nr sherbimeve preventive	6	6
52	F.V.aspirator te UPS	2	cope	3	6
	<b>Mirembajtja e gjeneratoreve</b>				-

53	. Kontroll vizual i gjëndjes së përgjithshme të gjeneratorit. Kontroll i jashtëm i gjëndjes së motorrit.Kontroll i jashtëm i gjëndjes së gjeneratorëve.Kontroll i tubacioneve të sistemit të furnizimit me karburant.Kontroll i gjëndjes fizike dhe regjistrimi i rripave të transmetimit të lëvizjes.Kontroll i kuadrit të automatikës, që përmbledh kontrollin e sistemit të kontrollit të parametrave dhe atij të komandimit automatik.Kontroll vizual i serbatorit për rrjedhje. Kontroll i gjeneratorit për shpërndarje ngarkesë nëpër fazë.Kontroll i lëngut ftohës në radiator. Kontroll i baterisë: terminaleve, elektrolitit dhe niveli të tensionit të saj.Testim i gjeneratorit në ngarkesë maksimale	3	Nr sherbimeve preventive	2	6
54	Kontroll periodik dhe Matje të izolacionit të vajit të transformatorëve, pajisjeve mbrojtëse dhe të punës	2	Nr sherbimeve preventive	2	4
55	FV vaj transformatori	2	Litra	50	100
	<b>Mirembajtja e gjeneratorit te Maternitetit te vjeter</b>				-
56	Furn.vend.filter ajri	1	Cope	1	1
57	Furn.vend.filter nafte	1	Cope	1	1
58	Furn.vend.filter vaji	1	Cope	1	1
59	Furnizim vaj motori per gjeneratorin	1	Litra	20	20
60	F.V.bateri 150 A	1	Cope	2	2
	<b>Mirembajtja e paneleve fotovoltaike</b>				-
61	Pastrim larje me solucion perkates te paneleve diellore	316	Nr sherbimeve preventive	1	316
62	Kontroll I siguresave DC dhe zevendesimi I tyre nese jane djegur	1	Nr sherbimeve preventive	1	1
63	Pastrim me kompresor te inverteve te paneleve diellore	6	Nr sherbimeve preventive	1	6
	<b>Pajisje hidro-mekanike për mbrojtja nga zjarri</b>				-
64	Kontroll dhe shërbime teknike Verifikimi sistemit të sinjalizimit të zjarrit. Prova në kampion e sensorëve të tymit me anë të bombulës së testimi. Pastrimi i sensorëve me anë të mjeteve të nevojshëm. Zëvendësimi i sensorëve në rast të dëmtimit të tyre.Verifikimi i paneleve lokal të sinjalizimit të zjarrit të ndarë në nivel kati.Verifiki i magnetëve të dyerve duke bërë edhe mirëmbajtjen e rastit. Testimi i sistemit të sinjalizimit të zjarrit me sektorë lokal, për të parë gjithë veprimet automatike që sistemi i zjarrit duhet të kryej.Verifikimi i sistemit audio të EVAKUIMIT	1	Nr sherbimeve preventive	6	6

65	Kontrolli i performancës së hidranteve të instaluar në kasete: saraçineska, tubi i ujit, lidhëset etj. si dhe kryerja e çdo shërbimi për dëmtime, korrozion, papastërti, rrjedhje, forca e lidhësve për funksionim normal (kontroll 1 herë në dy muaj)	12	Nr shërbimeve preventive	6	72
66	Kontroll, mirëmbajtje e rrjetit furnizimit me energji elektrike të komandimit dhe të mbrojtjes së elektropompës (1 herë në tre muaj)	1	Nr shërbimeve preventive	4	4
67	Mbushje dhe kolaudim i Fikseve zjarri me CO2. 6-8 kg	20	Cope	2	40
	<b>Mirembajtja e kompresoreve te ajrit</b>				-
68	F.V.filter ajri RS -11/15 RS-PRO 7,5 -11	3	Cope	1	3
69	F.V.filter vaji RS -3/9 RS-PRO 7,5 -11	3	Cope	1	3
70	F.V. ndares vaj/ajer RS-C 3/4 (NK-40)RS -PRO 7,5/11 (2NK)	3	Cope	1	3
71	Lubrifikant per vida kompresor RENNER D68 1lt	3	Litra	5	15
72	F.V.elementet e filtrit AF0106 P prefilter	1	Cope	1	1
73	F.V.elementet e filtrit AF0106M mikrofilter	1	Cope	1	1
74	shërbim preventiv i kompresoreve	3	Komplet	1	3
75	rakorde 241 1/4 6/8 pajisje	2	Cope	1	2
76	F.V. A4/Z 1/4 3/8 kontraktues amerikan	1	Cope	1	1
77	F.V. 6/8 R 15 M spiral bojeqielli	1	Cope	1	1
78	F.V.pistoletë JRI eco LI 30	1	Cope	1	1
79	F.V.FM 1/4 saraçineske (eksagon ball valvula sferike )	1	Cope	1	1
80	F.V.sensor temepature NTC IM thares RDP	3	Cope	1	3
	<b>Mirembajtja e Sistemit te furnizimit me ajër të vakumuar</b>				-
81	Shërbime teknike në pompa vakumi	2	Nr shërbimeve preventive	4	8
82	F.v. filtro e centralit të vakumit	1	Cope	1	1
83	F.v. vaj për centrale vakumi sipas specifikimeve teknike ISO VG 100/1-4lt, ME-30-6lt,180 6743-3A-DAB-10lt dhe që jepen me urdhër pune	1	Cope	10	10
84	Filter vaji	1	Cope	1	1
85	Filtra linje antibakterial kit	1	Cope	1	1
	<b>Mirembajtja e kondicionereve ne poliklinike dhe spital</b>				-
86	Kontroll i presionit dhe mbushje me gaz R407 & R410A & R32 per kondicionere	10	Kg.	2	20

	9000/12000/18000 btu/h				
87	Cmontim Furnizim Montim Elektrovalvol tre rrugshe kondicioner 9000/12000 /18000 btu/h	1	Cope	3	3
88	Cmontim Furnizim Montim Kondesator 30 mikrofarad 9000/12000 /18000 btu/h	1	Cope	2	2
89	Cmontim Furnizim Montim Kondesator 60 mikrofarad 9000/12000 /18000 btu/h	1	Cope	3	3
90	Zmontim Avolzhim Montim motorr kompresori kondicioneresh	1	Cope	2	2
91	Furnizim vendosje sistemim tub shkarkimi I kondensatit	1	MI	5	5
92	Cmontim Furnizim Montim sensor ajri 9000/12000 /18000 btu/h	1	Cope	3	3
93	Cmontim Riparim Montim pakete kondicioneri 9000/12000/18000 btu	1	Cope	2	2

**Afatet e ekzekutimit:** 12 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

#### Shtojca 7

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES PER TE GJITHA LOTET

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Spitali Rajonal Lezhe

**Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:** “Mirembajtja e impjanistikes për Spitalit Rajonal Lezhe - me afat 1 vjeçar (12 muaj)”- Marrëveshje kuadër me nje operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet jane te percaktuar,**Mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore**

Ne Spitalin Rajonal Lezhe ndodhen paisjet e meposhtme te cilat duhen te mirembahen :

Mirëmbajtja është ajo grup masash me natyrë tekniko-organizative, të cilat mund të përpunohen ose jo më parë, ***qëllimi i të cilave është të mbajnë funksionalitetin e pajisjeve dhe të garantojnë një gjendje optimale të makinerive dhe pajisjeve me kalimin e kohës.***

Ndër objektivat e mirëmbajtjes mund të përmenden: ruajtja e kapacitetit të punës së makinerive, zvogëlimi i ndalesave të papritura, kontribuimi në rritjen e produktivitetit, mbajtja e mjeteve në gjendje teknike shumë të mirë me një kosto minimale.

Përmes planeve të mirëmbajtjes synohet të rritet niveli i përdorimit të pajisjeve teknike, të ruhen ose rivendosen pajisjet në funksionim për të përmbushur funksionin e tyre, për të arritur efikasitetin maksimal të makineri-pajisjeve teknike.

***Detyrat e mirëmbajtjes janë ekskluzive jo vetëm për pajisjet dhe makineritë, por për të gjitha instalimet fikse ose të lëvizshme, ndërtesat industriale, tregtare ose shërbime specifike, domethënë, çdo lloj asemi apo aktiviteti të institucionit/entitetit publik apo privat.***

**Mirëmbajtje parandaluese**, për të cilat kryhet punë ciklike dhe përsëritëse me një frekuencë të përcaktuar për të arritur këtë objektiv.

---

Mirëmbajtja parandaluese ka disa modalitete: mund të jetë një proces që do të kryhet në mënyrë periodike, përgjithësisht me një interval kohor prej 200 deri në 800 orë shfytëzimi. Mund të programohet gjithashtu sipas specifikimeve të prodhuesve ose sipas standardeve të inxhinierisë.

**Mirëmbajtja totale** kërkon përsosmëri ose me një fjali: të marrë maksimumin me cilësi të pranueshme, me koston më të vogël të mundshme, në mënyrë të përhershme dhe me një kuptim integral. Për këtë, kryhen detyra të vogla mirëmbajtjeje si rregullimi, inspektimi, zëvendësimi i pjesëve dhe mirëmbahet një ndërveprim i vazhdueshëm me menaxherin e mirëmbajtjes.

**Programi përfshin tre parime:** gjithnjë mbani objektet në gjendje të mirë, përqendrohuni në rritjen e produktivitetit dhe përfshini të gjithë stafin.

Mirëmbajtja sot konsiderohet një përfitim, në vend të *një e keqe e domosdoshme*, dhe supozohet si një angazhim nga të gjithë sektorët e institucionit.

### **Sistemi gazeve mjekesore**

Sistemi i shpërndarjes së gazrave mjekësor është një element themelor për çdo institucion shëndetësor, pasi mundëson garantimin e vazhdueshmërisë operationale të furnizimit me gaz mjekësor (oksigjen, ajër mjekësor) dhe aspirimin me vakum, duke siguruar gjithmonë një trajtim të sigurt dhe efikas të pacientëve.

Shërbimi i riparimeve dhe mirëmbajtjes është një aktivitet kompleks dhe një politikë e saktë e mirëmbajtjes sjell përfitime në:

- sigurinë e pacientëve për sa i përket vazhdimësisë së furnizimit dhe cilësisë së gazrave të administruar;

- sigurinë e punonjësve teknikë dhe shëndetësorë për vazhdueshmërinë e aktivitetit dhe/ose menaxhimit të situatave emergjente;

- uljen e kostove për Autoritetin Kontraktor nga optimizimi i procesit të mirëmbajtjes me rrezikshmeri më të ulët të dështimeve të papritura dhe humbje të gazeve apo energjisë elektrike;

- mjedis me më pak ndotje duke parandaluar rrjedhje në mjedisin e gazit mjekësor.

- Operatori Ekonomik që do të kryejë shërbimet e riparim- mirëmbajtjes, duhet të ketë personel teknik të kualifikuar dhe të specializuar në mënyrë që të garantojë kryerjen e saktë të këtyre shërbimeve sipas standardeve UNI EN ISO 7396-1 2016 .

- Aktivitetet e riparim-mirëmbajtjes dhe furnizim-vendosjes duhet të kryhen në përputhje me udhëzimet e ofruara nga prodhuesi i këtyre sistemeve dhe specifikimeve teknike përkatëse .

- Aktivitetet që do të duhet të kryejë OE përfshijnë:

- Kontrolle periodike të planifikuara: kontrollet, testimet, rregullimet, zëvendësimet, pastrimin dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për të garantuar funksionimin dhe sigurinë në këto sisteme.

- Çdo sistem duhet t'i nënshtrohet kontrolleve periodike të planifikuara, për të vlerësuar gjendjen e performancës dhe funksionit të tyre, me frekuencë sipas specifikës teknike të çdo pajisjeje, referuar udhëzimeve të ofruara nga vetë prodhuesi si dhe udhëzimeve të A.K . Po ashtu

---

zëvendësimi i pjesëve të këmbimit të dëmtuara do të bëhet me urdhëra pune pas vlerësimit të defektit.

- Shërbimet teknike të planifikuara do të kryhen nga ora 8:30 deri në 20:00, në ditë të shtuna dhe diela, në ditët e pushimit dhe festave zyrtare, sipas udhëzimeve nga AK, pa e penguar kryerjen e shërbimit spitalor.

- Defektet e çastit: Riparim-shërbimet do të kryhen me marrjen e njoftimit, menjëherë, çdo ditë dhe në çdo orë.

- Të gjitha pjesët/zërat për furnizim-vendosje duhet të jenë të markuara CE dhe në përputhje me llojin e përshkruar nga prodhuesi i pajisjes ku do të zëvendësohen/ndërrohen.

Zëri shërbime teknike në kompresorët e ajrit dhe në linjat e komprimimit konsiston kryesisht në këto kontrolle dhe shërbime parësore:

- Kontroll vizual i gjëndjes së përgjithshme të kompresorëve, tharëse.
- Kontroll i nivelit të vajit në kompresor.
- Kontroll i gjëndjes së filtrave të vajit e të ajrit.
- Kontroll i jashtëm i gjëndjes së motorëve elektrikë.
- Kontroll i gjëndjes fizike i rripave të transmisionit.
- Kontrolli i paneleve të automatikës, tarimi i tyre, vënia në punë me presostat.
- Kontroll i lëshuesave.
- Kontroll i manometrave dhe depozitave.
- Kontroll i filtrave të lagështirës.
- Kontroll i reduktorëve të presionit.
- Kontroll i valvulave elektrike në çisterna.

Zëri shërbime teknike në pompat dhe në linjat e vakumit konsiston kryesisht në këto kontrolle dhe shërbime parësore:

- Kontroll i gjëndjes së pompave të vakumit nga ana elektrike dhe mekanike.
- Kontroll i paneleve kryesore elektrike.
- Kontroll i filtrave të vajit e të ajrit.
- Kontroll i manometrave të presionit në linjë e në depozitë.

Zëri kontrolli dhe shërbim i rampave të gatishmërisë, linjave, paneleve, manometrave të oksigjenit konsiston kryesisht në:

- Kontroll i rampave të emergjencës.

- Kontroll i linjave.
- Kontroll i reduktorit kryesor.
- Kontroll i valvulave të sigurisë.
- Kontroll i manometrave.

### **Sistemi i ngrohjes – ftohjes me chiller dhe kaldajë, prodhimit të ujit sanitary dhe avullit, sistemi ventilim – kondicionimit dhe trajtimit të ajrit në Maternitetin Lezhe**

Materniteti ka një Qendër Teknike (kati perdhe ), ku janë instaluar sistemet qendrore të ngrohjes, të ujit të ngrohtë, të avullit për sterilizim, kondicionimit,

Sistemi i Ngrhjes dhe Ftohjes, janë projektuar dhe zbatuar me impiante qendrore të instaluara në ndërtesën teknike, po kështu funksionojnë edhe kaldajat e prodhimit të ujit sanitar dhe të avullit.

#### **Në këtë sistem ndodhen këto paisje:**

##### **1. Kaldajë ngrohje me prodhim nxehtësie max/min : 611/940 kW, cope 2(dy)**

Karakteristikat Teknike :

- Fuqia termike min/max : 611/940 kW,
- Dimensioni tubi dergim / kthim :  
DN 100 " / DN 100 "
- Dimensioni i kanalit te tymit : Ø 350 mm
- Presioni max: - 6 bar
- Humbja ne shkarkimin e tymit: 5.4 mbar

I kompletuar me valvola nderprerese, sigurie , shkarkimi, manometer, termometer, sensor elektronik etj.

##### **2. Gjeneratori indirekt i avullit, që shërben për sistemin e kondicionim dhe ventilimit.**

GJERENRATOR AVULLI per A.H.U. cope 3 (tre)

Karakteristikat Teknike :

- Sasia e avullit te prodhuar :9-90 kg/h
- Presioni min/max i punes : 1 -10 bar
- Fuqia elektrike 2x34.2 kW,(400V - 3F~ 50Hz)
- Dimensionet: AxBXC = 675 x 730 385 mm

I kompletuar me panel elektrik dhe te gjithë aksesoret e nevojshme per funksionimim.

##### **3. Çillera me ajër të ftohtë me shpejtësi të variushme, kapaciteti ftohës 561 / 423 kW cope 2 (dy).**

(Versioni ajer / uje Inverter, komplet me kitin hidraulik).

Kapaciteti ftohes / ngrohes: 561 / 423 kW .

Temp. te jashtme vere / dimer : 36°C / -1°C - 100950 l/h

Fuqia elektrike / tensioni / intensiteti /ushqimi : 210 kW / 400V / 364 A / 3 F ~ 50Hz .

Kit hidraulik ( akumulator, ene zgjerimi, pompe riqarkullimi inverter, valvol, etj..).

---

Grup mbushje automatike, sensor komplet. dhe mbrojtje automatike kunder ngrirjes.  
Kompletuar me strukture metalike mbeshetse me amortizator.  
Dimensione: AxBxH= 5.95X2.2X2.45 m, Pesha 4860 kg.

Njesi te jashtme pompe nxehtesie , MULTI-SPLIT me 5 dalje type, kompresor inverter, gas pune R410A, 1faze/ 50Hz/ 230V. Kapaciteti 12.1 kW ftohje. Vmed.=5200 m<sup>3</sup>/h, Fuqia elektrike 5.02 kW.

I kompletuar me te gjitha Aksesorët e nevojshem per funksionim normal

4. NJESI TRAJTIMI AJRI - BLOKU OPERATOR MATERNITETI. 1 (nje)  
Prurja e ajrit dergim/kthim 9500 / 8500 m<sup>3</sup>/h .  
Temperatura / lageshtia ne hyrje te ambientit dimer: 34°C/ 55% , vere 19°C/ 59.5%  
Renia e presionit te jashtem dergim/kthim 600/250 Pa.  
Kapaciteti termik ne ngrohje / ftohje: 60.42 kW / 101.85 kW  
Bateria pas ngrohese elektrike me fuqi 25.69 kW elektrike .  
Fuqia elektrike e ventilatorit / dergim 11 kW 3 F+N/400V/50Hz / kthim 4 kW 3 F+N/400V/50Hz  
Kompletuar me Inverter shpejtesie  
Efikasiteti i rekuperatorit 74.4/76.4%.  
Komplet filtrash, komplet kuader elektrik, set sensoresh, mbrojtje automatike nga ngrirja, strukture e tipit te jashtem.  
Dimensionet AxBxH [mm]: 7898x1694x2128. Pesha totale 2513 kg).
  
5. NJESI TRAJTIMI AJRI E PERGJITHSHME - MATERNITETI. Cope 1(nje)  
  
Prurja e ajrit dergim/kthim 9600 / 10500 m<sup>3</sup>/h .  
Renia e presionit te jashtem dergim/kthim 150/150 Pa.  
Kapaciteti termik ne ngrohje / ftohje: 47.1 kW / 48.88 kW  
Fuqia elektrike e ventilatorit / dergim 4 kW 3 F+N/400V/50Hz / kthim 4 kW 3 F+N/400V/50Hz  
Kompletuar me Inverter shpejtesie  
Efikasiteti i rekuperatorit 74.8/84.5%.  
Komplet filtrash, komplet kuader elektrik, set sensoresh, rregullator klimaterik, strukture e tipit te jashtem.  
Dimensionet AxBxH [mm]: 6778x1374x2448. Pesha totale 4122 kg)
  
6. Sistemi i ujit sanitar i përbërë nga një sistem pompash, këmbyesish nxehtësie 2 x 5000 litra dhe paisjesh kontrolluese dhe matëse.

Mirëmbajtja dhe riparimet e sistemeve të ftohje-ngrohjes, të prodhimit të ujit sanitar, avullit dhe , kryhen sipas preventivit pjesë përbërëse e kontratës.

Gjatë zbatimit riparim-mirëmbajtja kryhet me “Autorizim per kryerje sherbimesh “ të lëshuar nga specialistët

Drejtori , dhe në përfundim të shërbimeve teknike apo riparimeve

hartohet proces verbali i marrjes në dorëzim ku nënshkruajnë të dy palët.

---

Duhet të sigurohet gadishmëri teknike dhe shfrytëzimi 24/24 orë, dhe me temperaturë të brendshme 20 - 22 °C.

“Autorizim për kryerje shërbimesh “ për riparime të defekteve të çastit shoqërohet me preventiv të hartuar nga përgjegjesi i sektorit teknik,

Preventivi përmban njësinë, sasinë, çmimin, vlerën dhe kohën e kryerjes së riparimit të defekteve; çmimet merren nga oferta fituese, që është pjesë përbërëse e kontratës.

Kontroll dhe shërbim periodik mujor jepen në Autorizim për kryerje shërbimesh përfshihen:

Mirëmbajtja e këtyre sistemeve kërkon kryerjen e shërbimeve teknike dhe të riparimeve të çastit (emergjente) si më poshtë :

- Pastrimi dhe mirëmbajtje filtrash
- Zëvendësimi i filtërave të dëmtuar (sipas specifikimeve teknike)
- Pastrimi brënda dhe jashtë e baterive të shkëmbimit nxehtësisë,
- Kontrolli i presionit dhe plotësimi i sasisë së gazit freon,
- Kontrolli dhe plotësimi i vajit;
- Kontrolli, larje-pastrimi i serpentinave dhe aksesorëve të tjerë
- Kontrolli i funksionimit të kompresorëve
- Kontrolli, pastrimi dhe shërbimi i aspiratorëve (elikave) përeleminimin, disbalancimi gjatë punës;
- Kontrolli, shërbimi dhe pastrimi i fryrësave fancoil tavanor dhe të dyshemesë
- Kontrolli dhe mirëmbajtje e tokëzimit të motorëve elektrikë;
- Kryerjen e çdo kontrolli dhe shërbimi tjetër mirëmbajtës, të nevojshëm për funksionimin normal të impianteve;

Shërbimet dhe riparimet që do të kryhen, janë të përshkruara në preventivat bashkëngjitur,

Riparimet e çastit duhet të kryhen menjëherë, me marrjen e njoftimit.

Për çdo shërbim e riparim që do të kryhet, hapet Autorizim për kryerje shërbimesh me preventivin, i cili merret nga preventivi fitues, si dhe me kohën e kryerjes,

a) Vendi i kryerjes së riparim-shërbimeve është:

- Godina e Shërbimit Spitalor;
- Godina Teknike, ku janë të instaluar maknieritë dhe paisjet;

---

b) Grafiku i lëvrimit (koha e kryerjes së riparim-shërbimeve):

Shërbimet teknike dhe riparimet e planifikuara, që jepen me “Autorizim per kryerje shërbimesh”, do të kryhen nga ora 8:30 deri në 20:00, në ditë të shtuna dhe të diela, pa e penguar kryerjen e shërbimit spitalor.

Për rastet e defekteve të çastit (emergjente), riparim-shërbimet do të kryhen me marrjen e njoftimit, menjëherë, çdo ditë dhe në çdo orë.

c) Koha e kryerjes së riparim-shërbimeve :

Shërbimet teknike dhe riparimet e planifikuara, që jepen me “Autorizim per kryerje shërbimesh” do të kryhen nga ora 8:30 deri në 20:00, në ditë të shtuna dhe të diela, pa e penguar kryerjen e shërbimit spitalor.

Për rastet e defekteve të çastit (emergjente), riparim-shërbimet do të kryhen nga e hëna deri të dielën, në çdo orë, menjëherë.

Sistemi i aspirimit dhe trajtimit të ajrit duhet të funksionojë 24 orë/24 orë.

ç) Operatorët Ekonomikë, duhet të:

Njihen me këto sisteme dhe të deklarojnë që marrin përsipër kryerjen e këtyre riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse, në çdo orë dhe në cdo kohë, me marrjen e njoftimit, dhe me cilësinë e kërkuar për shërbim spitalor të certifikuar

Kontroll dhe shërbim periodik mujor i chillerit, sipas grafikut të hartuar nga përfaqësuesi i sektorit Teknik

dhe inventarit, ku përfshihen:

Pastrim dhe mirëmbajtje filtrash çdo 60 (gjashtedhjetë) ditë;

Pastrim brenda dhe jashtë të baterive të shkëmbimit nxehtësisë çdo 60 (gjashtedhjetë)

Kontroll i presionit dhe plotësimi i sasisë së gazit freon

Kontroll dhe plotësimi i vajit;

Kontroll, larje-pastrimi i serpentinave dhe aksesorëve të tjerë

Kontroll i funksionimit të kompresorëve (me kapacitet sipas preventivit)

Kontroll, pastrimi dhe shërbimi i aspiratorëve (elikeve) për eliminimin, disbalancimi gjatë punës;

Kontrolli dhe shërbimi i fryrësave dhe fancoli-ve tavanorë

Kontrolli dhe mirëmbajtja e paisjeve elektrike të punës dhe të mbrojtjes;

- 
- Kontrolli dhe mirëmbajtje e tokëzimit të motorëve elektrik;
  - Kryerjen e çdo kontrolli dhe shërbimi tjetër mirëmbajtës, të nevojshëm për funksionimin normal të impiantëve;
  - Kondicionerët janë të të gjitha markave të tregtuara në vend nga viti 2002-2016, dhe me kapacitet 9000-24000 BTU.
  - Gazi që do të përdoret: -gaz freon ekologjik R 407- R410,

b) Zëvendësimi i pjesëve të ndërrimit të dëmtuara, sipas preventivit përkatës.

c) Për të kryer shërbimet në blloqet operatore dhe reanimatore, duhet që të sigurohet temperatura e brendshme 18-20°C, ndërsa në pavionet e godinave spitalore duhet temperature 20 -22°C .

### **Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit ,transformatoreve,gjeneratoreve ,UPS -ve**

Ne kabinen elektrike te spitalit gjenden dy tranformatore 400KVA njeri per furnizimin e godines se spitalit dhe tjetri per furnizimin me energji elektrike te godines se Maternitetit te ri

Sipërmarrësi do të kryejë riparim-mirëmbajtjen e këtyre sistemeve duke zbatuar të gjitha procedurat e duhura teknike dhe ligjore.

Sipërmarrësi do të realizojë shërbimet periodike të mirëmbajtjes, si dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit sipas me “Autorizim per kryerje shërbimesh ” të lëshuar nga drejtori I spitalit ,pas preventivit te pergjegjgesit te sektorit teknik

Sipërmarrësi do të kryejë shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes javore e mujore.

Qëllimi i kryerjes së shërbimit të riparim-mirëmbajtjes së kabinës elektrike të Spitalit të Ri është që të sigurohet gadishmëria, vazhdimësia në punë në kushte optimale dhe brënda normave të sigurimit teknik.

### **Shërbimi i mirëmbajtjes duhet të përqëndrohet në:**

Verifikimi i temperaturës së funksionimit të transformatorit hedhja e vajit nese eshte nen nivelin e duhur dhe kontrole të tjera

Verifikimi i funksionimit të grupit të ndërhyrjes në qarqet ndihmës.

Verifikimi i qarqeve ndihmës.

Verifikimi i funksionimit të nxjerrjes së ajrit dhe termostatit përkatës në ambjentin e komandimit.

Pastrimi i përgjithshëm e ambientit dhe e grilave të shkëmbimit të ajrit.

Verifikimi i grupit të gjeneratorit si edhe shërbimi periodik i tij:

---

Vënia në punë në mënyre periodike për një kohëzgjatje prej 1 ore për të kontrolluar të gjithë parametrat e nevojshëm të gjeneratorit. Ky veprim do të bëhet me radhë për secilin gjenerator dhe realizohet me “Autorizim dhe kryerje shërbimit “ të veçantë.

Shërbimi periodik i grupit të gjeneratoreve:

Ndërrimi i filtrave të vajit, ajrit, naftës dhe të ujit.

Ndërrimi i vajit

Kontroll vizual i gjëndjes së përgjithshme të gjeneratorit,

Kontroll i jashtëm i gjëndjes së motorrit,

Kontroll i jashtëm i gjëndjes së gjeneratorit,

Kontroll i tubacioneve të sistemit të furnizimit me karburant,

Kontroll i gjëndjes fizike dhe regjistrimi i rripave të transmetimit të lëvizjes,

Kontroll i kuadrit të automatikës që përmbledh kontrollin e sistemit të kontrollit të parametrave dhe atij të komandimit automatik,

Kontroll vizual i serbatorit për rrjedhje,

Kontroll i gjeneratorit për shpërndarje ngarkese nëpër fazë,

Kontroll i lëngut ftohës në radiator,

Kontroll i baterisë terminaleve, elektrolitit dhe niveli të tensionit të saj,

Testim i gjeneratorit në ngarkesë maksimale.

Kontrolli i lidhjes të saktë të kapikordave me kolektorin e tokës,

Verifikimi i tokëzimit etj.

Verifikimi i paisjeve të UPS 1, 2,

Pastrimi i gjithë pjesëve të brendshme të pajisjes,

Kontrollin funksional të parametrave të pajisjes së bashku me matjet përkatëse,

Kontroll dhe verifikim i anës cilësore të baterive që garanton kohëmbajtjen e pavarur të ngarkesës së punës nga burimet e tjera të rrymës alternative, që janë linja nga OSHEE dhe gjeneratori.

Kontrolli i cilësisë të mbrojtjes të furnizimit me energji të pajisjes, si dhe asaj të transmetuar, Verifikimi i gjëndjes të sistemit të tokëzimit duke iu referuar tokëzimit kryesor të objektit në të cilën është e instaluar UPS.

Në të gjitha rastet si me bateri të inkluduara në UPS ashtu edhe me bateri të jashtme kryhet ndarja e linjës pozitive nga ajo negative dhe bëhet matja e kapacitetit të dy linjave.

Shtrëngimi i të gjithë urave të lidhjes së baterive në seri,

---

Kontrolli dhe pastrimi i poleve të baterive.

Verifikimi i impiantit të ndricimit të sigurisë së emergjencës:

Prova e ndërhyrjes automatike në mungesë të rrjetit OSHEE,

Testimi i kohëzgjatjes së ndricuesave të emergjencës,

Zëvendësimi i llampave të emergjencës në rast të dëmtimit të tyre,

Zëvendësimi i paketës së baterisë së emergjencës në rast dëmtimi,

Verifikimi i tokëzimit etj.

### **Verifikimi sistemit të sinjalizimit të zjarrit.**

Prova në kampion e sensorëve të tymit me anë të bombulës së testimit,

Pastrimi i sensorëve me anë të mjeteve të nevojshëm për këtë qëllim,

Zëvendësimi i sensorëve në rast të dëmtimit të tyre,

Verifikimi i paneleve lokal të sinjalizimit të zjarrit të ndarë në nivel kati,

Verifikimi i magnetëve të dyerve duke bërë edhe mirëmbajtjen e rastit,

Testimi i sistemit të sinjalizimit të zjarrit me sektorë lokal, për të parë gjithë veprimet automatike që sistemi i zjarrit duhet të kryejë,

Verifikimi i ushqyesave lokal që furnizojnë me energji magnetët e dyerve,

Verifikimi i sistemit audio të EVAKUIMIT në rast zjarri.

### **Verifikimi i sistemit të thirjes së infermierisë.**

Kontrolli vizual i paisjeve të sinjalizimit të infermieres,

Testimi i paisjeve dhe verifikimi i thirjes nga dhoma deri në sallën e infermieres.

Verifikimi i funksionimit të llampës së sinjalizimit të qarqeve c'kycëse.

### **Kërkesat teknike për sistemin e furnizimit me energji elektrike nga rrjeti dhe motogeneratorët janë:**

1- Operatorët ekonomik duhet të njihen me preventivin e punimeve, gjendjen faktike të kabinave, moto-gjenerator dhe të deklarojnë që marrin përsipër mirëmbajtjen e tyre.

2- Operatori ekonomik të kenë persona përgjegjës inxhinier elektrik, që të përgjigjen për riparim defekteve në cdo kohë dhe të kenë shërbim 24 orë, ditë të shtuna, diela e festa zyrtare , për riparimet e castit duhet të kryhen me marrjen e njoftimit ndërsa për shërbimet periodike kryhen periodikisht cdo muaj sipas urdhërit të punës.

3- Operatori ekonomik, duhet të kontaktoj cdo ditë me personat përgjegjës të Sektorit Teknik dhe duhet të raportojnë për anomali apo defekte gjatë natës.

---

**Shpërndarja:** Në godinat e Spitalit rajonal Lezhe, në të gjitha shërbimet ku ndodhen pajisjet mjekësore të cilat janë përcaktuar në tabelat e detajuara dhe do të rifreskohen në momentin e lidhjes së kontratës me Operatorin Ekonomik fitues.

**Shënim:** Ndërprerja e Kontratës - Të parashikohet ndërprerja e kontratës për ato zëra kur përfundon supporti nga prodhuesi. Këto parashikime të jenë vetëm në rastet e paraqitjes së një dokumentacioni vërtetues nga prodhuesi. Afati i njoftimit të jetë jo më pak se 30 ditë.

**Vendi i krverjes së shërbimeve:** Drejtoria e Spitali Rajonal Lezhe

**Shtojca 8**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

## **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

---

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

*b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;*

*c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

*d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*Shuma e sigurimit të ofertës është: 154,513.94 (njqind e pesedhjetë e kater mije e peseqind e trembedhjetë pike ) leke*

#### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

##### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**Kriter 2.1.1** Operatori duhet të ketë çertifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

##### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

---

**Kriter 2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet financiare të fundit nga data e hapjes së ofertave: ku vlera e xhiros vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit.

*Vlera mesatare e xhiros së këtyre tre viteve duhet të jetë : 3,090,278.80 (tre milion e nentëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tete) leke*

**Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur..**

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Kriteri 2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, kontratën e shërbimit, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet

*Vlera për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës duhet të jetë: 1,545,139.40 (një milion e pesëqind e dyzetë e pese mijë e njëqind e tridhjetë e nente pike 4) leke.*

**Kriteri 2.3.2** Licensë profesionale e Shoqërisë e vlefshme me kategorinë

- **NS 12-A** ; ( **Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit**)

*Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.”*

- **NS 14-B** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.

**Kriteri 2.3.3.** Operatori/et ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht të punësuar, si më poshtë:

